



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

01. nr. 020/040/2530/19, më 27-05-2019

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/04, qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR ZHVILLIMIN E DISKUTIMIT PUBLIK TË RREGULLORES PËR THEMELIMIN DHE STRUKTURIMIN E ASAMBLESË KOMUNALE PËR FËMIJË

- I. Miratohet Vendimi për formimin e komisionit për zhvillimin e diskutimit publik të Rregullores për themelimin dhe strukturimin e Asamblesë Komunale për Fëmijë.
- II. Komisioni i cekur në pikën I të këtij vendimi, është në këtë përbërje:
 1. Premtime Preniqi, kryesuese;
 2. Ajshe Bërveniku, anëtare;
 3. Florina Maloku, anëtare;
 4. Ardiana Ismaili, anëtare;
 5. Leonora Spahiu, anëtare;
 6. Lindita Hajdari, anëtare.
- III. Detyrë e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi, është që të kujdeset për zhvillimin e diskutimit publik të Rregullores për themelimin dhe strukturimin e Asamblesë Komunale për Fëmijë, dhe të shqyrtojë dhe evidentojë të gjitha ankesat, vërejtjet dhe sugjerimet e publikut të bëra gjatë diskutimit publik.
- IV. Për kryerjen e detyrave të cekura në pikën III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Anëtareve të komisionit,
- Qendrës për shërbime me qytetarë,
- Në dosje.

